

ÇLIRIM DURO

Universiteti i Tiranës / Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë
clirimduro@gmail.com

ARBEN JAUPAJ

Studiuues
arben_jaupaj@hotmail.com

**PROCESET POLITIKE QË SHËNJUAN NËNSHTRIMIN
E KISHËS ORTODOKSE AUTOQEFALE NGA SHTETI
KOMUNIST NË VITET 1945-1949****Abstrakt:**

Ky artikull synon të analizojë proceset politike të ndodhura në vendin tonë, në periudhën 1945-1949, duke u fokusuar në disa prej ngjarjeve më të rëndësishme. Mbarimi i luftës dhe rindërtimi i vendit do të hapë një kapitull të ri për shoqërinë shqiptare dhe institucionet e saj. Regjimi i ri komunist, ndryshe nga paraardhësit e tij, do të ketë një qasje të re me komunitetet fetare në vend. Një nga aspektet më të vështira në marrëdhëniet e kishës me shtetin komunist, ishte ajo me natyrë ekonomike. Pas çlirimit, shteti kreu reforma të thella në lëmin ekonomik, ndër të cilat Reforma Agrare ishte më e rëndësishmja. Nga ana tjetër, reforma arsimore solli shtetëzimin e të gjitha shkollave private në vend e për konsekuencë të të vetmit seminar fetar ortodoks. Viti 1948 përfaqëson një tjetër moment të rëndësishëm në zhvillimet e brendshme të shtetit dhe shoqërisë, forcimin e marrëdhënieve me Bashkimin Sovjetik. Në rrugën e kontrollit dhe të mobilizimit të institucioneve fetare akti më i rëndësishëm i qeverisë shqiptare ishte shpallja e dekretligjit nr. 743, datë 26 nëntor 1949.

Fjalë kyçe:

Regjimi komunist, Kisha Ortodokse Shqiptare, Lufta e Dytë Botërore, këshilltarë sovjetikë etj.

Realiteti i ri social-politik pas luftës

Mbarimi i Luftës së Dytë Botërore e gjeti Shqipërinë me një trashëgimi institucionale modeste. Shteti shqiptar, i formuar në nëntor të vitit 1912 nën garancinë e Fuqive të Mëdha europiane në formën juridike të principatës së trashëgueshme, kaloi peripeci të shumta politike. Themelet e shtetit modern u hodhën në vitin 1920 dhe nga ajo periudhë deri në fund të Luftës së Dytë Botërore, vendi do të jetë republikë parlamentare, monarki kushtetuese nën Mbretin shqiptar Ahmet Zogu dhe pjesë e Monarkisë Italiane të shtëpisë Savoja pas aneksimit nga Italia në prill të 1939-s.

Pas luftës situata social-ekonomike e vendit ishte e zymtë. Pjesa dërrmuese e popullsisë jetonte në fshat e organizuar në sisteme patriarkale në zonat malore dhe e dominuar nga marrëdhëniet gjysmë-feudale në ato fushore. Në qytete mungonte klasa punëtore si grup i konsoliduar shoqëror, shumica e popullsisë ishte analfabete, zhvillimi industrial, agroindustrial, arsimor dhe infrastrukturor ishte në nivelet më të ulëta në Europë.

Grupimi politik që doli fitues dhe erdhi në pushtet pas përfundimit të luftës ishte Partia Komuniste Shqiptare (PKSH). Konteksti historik solli që PKSH-ja të ishte një grupim politik pa rivalë, të cilët mund ta kushtëzonin në administrimin e pushtetit. Drejtuesit e saj të lartë ishin të orientuar teorikisht ndaj modelit të centralizuar shtetëror sovjetik të përcjellë fillimisht nga këshilltarët jugosllavë të Kominternit dhe pas luftës në praktikë nga këshilltarët sovjetikë.

Vendimet e para për alternativën e zhvillimit social-ekonomik, u morën në mbledhjen e udhëheqjes së lartë komuniste (Plenumin e 4-t të KQ të PKSH-së) në tetor të vitit 1945.¹ Në fillim të vitit 1946, udhëheqja politike shqiptare vendosi të radikalizojë reformat social-ekonomike. Kundërshtimeve të brendshme për anashkalim të frymës së alternativës së miratuar, Enver Hoxha iu përgjigj duke organizuar një takim me udhëheqjen e lartë në shkurt të 1946-s (Plenumi i 5-të i KQ të PKSH-së),²

¹ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. IV, Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj (1939-1990), Grup autorësh, Botim i Akademisë së Shkencave, Instituti i Historisë (Tiranë: Toena, 2009), 164.

² *Po aty*, 182.

i cili sanksionoi linjën radikale të reformave dhe goditi krahun moderator. Parimi i gradualitetit dhe i karakterit liberal-demokrat i etapës së parë të reformave u braktis në harkun e tre muajve.

Goditjet e klerit ortodoks

Mbarimi i luftës dhe rindërtimi i vendit do të hapë një kapitull të ri për shoqërinë shqiptare dhe institucionet e saj. Kisha Ortodokse Autoqefale Shqiptare (KOASH) do të ishte një nga këto institucione të rëndësishme që do të përballlej me sfidat e reja. Në situatën e re politike dhe nën regjimin e ri, kisha do të përpiqej të ruante statusin ligjor të paraluftës. Në kushtet kur pushteti i ri do të fillonte procesin e ndërtimit të vendit nëpërmjet filozofisë së indoktrinimit ideologjik të mbështetur në metodat e huazuara marksiste, raportet e kishës me të do të ndryshonin në mënyrë të pashmangshme.

Për figurën e Kristofor Kisit ende dihet pak. Të dhënat biografike për të nuk janë të plota. Dimë që Kisi u diplomua në shkollën teologjike të Haklit në Stamboll. U dorëzua prift në vitin 1908 dhe peshkop më 1917 si peshkop i Siridonit. Në Shqipëri erdhi në gusht të vitit 1923 si peshkop ortodoks pa lejen e Patrikanës, për të dhënë kontribut për kishën kombëtare. Roli i Kisit në krijimin e Kishës Autoqefale Shqiptare është i njohur dhe i pranuar. Një nga aktet më të rëndësishme të tij ishte dorëzimi peshkop i Theofan Nolit në dhjetor të vitit 1923, akt i cili do të shërbente për konsolidimin e kishës së re. Më 1937 merr primatin e kishës shqiptare të njohur si autoqefale nga Patrikana e Stambollit. Si kryepeshkop në drejtimin e kishës dimë pak për veprimtarinë e tij në periudhën 1937-1939. Gjatë pushtimit fashist, kleri ortodoks do të gjendet në situata të vështira për shkak të synimeve të regjimit fashist ndaj kishës ortodokse. Situata mbas çlirimit nuk do të përmirësohet, me krijimin e Republikës Popullore raportet e klerit me shtetin e ri do të jenë të vështira për shkak të boshtit ideologjik të këtij të fundit.

Kreu i kishës, kryepeshkopi Kristofor Kisi, i njohur për qëndrimet e tij elastike u përpoq të krijonte marrëdhënie të mira me pushtetin e ri, duke ushqyer drojën për të ardhmen e kishës në vitet në vazhdim. Kjo drojë buronte nga natyra e regjimit, të cilin prelatët e lartë e njihnin dhe nuk ushqenin iluzione. Për këtë arsye, Kisi adoptoi qëndrime entuziaste për vlerat e Luftës Antifashiste. Një nga qëndrimet domethënëse të këtij vullneti, të shprehura nga kryetari i kishës, ishte udhëzimi drejtuar degëve

lokale në vitin 1946 për shmangien e ceremonive fetare mortore për të pushkatuarit nga qeveria.³ Njëkohësisht i kërkoi qeverisë së re të njihte dhe të zbatonte detyrimet ndaj kishës, detyrime kryesisht të karakterit financiar që rridhnin nga statusi i trashëguar i saj në raport me shtetin.

Vetëm në vitin 1946, qeveria pranoi t'i njihte këto detyrime pas një sërë demarshesh nga ana e kishës. Në fakt, regjimi i ri, i cili ende nuk ishte konsoliduar dhe kishte probleme të shumta të jashtme e të brendshme, do të mbajë qëndrime të dyfishta ndaj kishës dhe klerit. Ky do të jetë një tipar që do t'i karakterizojë këto marrëdhënie deri në fund.

Përfundimi i luftës hapi një kapitull të ri në marrëdhëniet e shtetit me Komunitetin Ortodoks. Pjesa më e madhe e besimtarëve ortodoksë e kishte pritur keq okupimin e Shqipërisë dhe një pjesë e tyre e kundërshtoi duke u bashkuar me formacionet partizane. Klerikët ortodoksë, mes të cilëve peshkopët e ardhshëm Paise dhe Damjano, u angazhuan duke dhënë një kontribut aktiv në luftë, disa prej tyre si etërit Jorgji Pano dhe Petro Shanto ranë dëshmorë të kauzës kombëtare. Klerikët të cilët mbas luftës u vunë në shënjestër të regjimit të ri ishin ata që u konsideruan si kundërshtarë, dhe gjatë luftës kishin shprehur qëndrime dyshuese ndaj ardhjes së komunistëve në pushtet. Dy nga figurat përfaqësuese të kishës që u goditën, ishin peshkopët Visarion dhe Irine.

I pari ishte Visarioni, një nga themeluesit e Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare, i thirrur nga Kisi në vitin 1942, kur u plotësua Sinodi i Shenjtë dhe i ngarkuar me detyrën e peshkopit të Beratit dhe të Vlorës. I dorëzuar peshkop në Mal të Zi në vitin 1925 nga dy peshkopë rusë, azilantë politikë: Ermogeni i Ekaterinosllavit dhe Mihaili i Aleksandrovskit, ai u thirr po këtë vit nga Këshilli i Lartë Kishtar i dalë nga Kongresi i Beratit, i cili i beson Mitropolinë e Durrësit. Në shkurt të vitit 1929, Visarionit i njihet me dekret mbretëror grada e peshkopit, duke u hapur rruga për krijimin e Sinodit të Shenjtë. Po këtë vit, Visarioni bashkë me peshkopin serb Viktor, dorëzuan tre peshkopë të rinj shqiptarë: Çamçen, Eftimin, Ambrozin duke formuar Sinodin e kishës. I shkishëruar nga Patrikana e Stambollit dhe i dorëhequr me imponimin e saj, Visarioni u thirr nga Kisi në vitin 1942, për të qenë anëtar i Sinodit dhe peshkop i dioqezës së Beratit.

³ Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSH), Fondi (më tej: F.) 536, Viti (më tej: V.) 1945, Dosja (më tej: D.) 18, fl. 2. Qarkore e Sinodit të Shenjtë drejtuar zëvendësive lokale.

Regjimi komunist kishte arsye më konkrete për ta konsideruar peshkopin Visarion si një kundërshtar të vendosur të tij. Në fazën e okupimit gjerman, Visarioni filloi në dhjetor të vitit 1943 një fushatë konferencash në kishat e dioqezës së tij. Motivet e tyre ai i shpjegon në një letër informuese drejtuar në atë kohë Këshillit të Lartë të Regjencës. Në të, ai përshkruan me terma të përgjithshëm bindjet që buronin nga doktrina kristiane për predikimin në popull të rreziqeve që vinin nga humbja e besimit të feja, rëndësinë e solidaritetit mes besimtarëve, normat e moralit kristian për vrasjet, vrasësit dhe terrorizimet, pamundësinë e realizimit të lumturisë në këtë jetë, si dhe “me bindjen ndaj urdhnit të sundimit të vendit, që asht dhe detyrë fetare e të krishtenit”.⁴

Megjithatë, Visarioni qëndroi në detyrë deri në burgosjen e tij në qershor të 1947-s. Mbas kalvarit të hetuesisë, më 23 dhjetor 1947, atij i lexohet vendimi i Gjykatës Ushtarake të Vlorës që e dënoi për bashkëpunim me pushtuesit e kolaboracionistët dhe për qëndrime kundër Luftës Nacionalçlirimtare e pushtetit të ri popullor me 20 vjet burgim dhe 5 vjet heqje të të drejtave politike. Më pas, nga viti 1948 deri në vitin 1962, ai kryen dënimin në burgun e Burrelit. Mbas lirimit dhe qëndrimit për një periudhë prej 3 vjetësh në Elbasan, në vitin 1965 internohet në Manastirin e Shën Gjoni Vladimirit, ku ndërroi jetë po atë vit.

I emëruar nga Kryesia e kishës si profesor në seminarin ortodoks “Apostulli Pavël” në vitin 1938, Ilia Banushi emërohet njëkohësisht edhe nga Ministria e Arsimit si profesor i gjuhës latine dhe i historisë pranë Gjimnazit të Shtetit në Tiranë. Formimi i tij patriotik dhe artikujt përparimtarë publicistikë ranë në sy të fashistëve italianë, të cilët e arrestuan tre muaj pas pushtimit dhe më vonë e internuan në Itali. Në korrik të 1940-s, Ilia Banushi kthehet nga internimi dhe pasi punoi për një periudhë kohe si mësues, në janar të vitit 1942 vendosi të dorëzohej prift.

Vendimin për të nisur jetën klerikale, ai e mori pas propozimit të Kristofor Kisit, kryepeshkopit ortodoks, i cili ndodhej në kushtet e presionit të uniatizmit. Profesor Ilia do t’i ngjiste të gjitha shkallët e karrierës fetare në një hark kohor prej tri ditësh dhe më 2 shkurt 1942 u hirotonis peshkop me emrin Irine - peshkop i Apolonisë, në një ceremoni

⁴ Nos Xhuvani, *Visarion Xhuvani, apostull i atdhetarizmit dhe i ortodoksisë shqiptare*, (Tiranë: Albania, 2003), 222.

të organizuar në Manastirin e Shën Naumit në Pogradec. Irineu dhe Visarioni plotësuan vendet bosh në Sinodin e Shenjtë, si dhe mundësuan shmangien e emërimit të peshkopëve uniatë.

Pas çlirimit të vendit nga pushtuesit nazifashistë, Irineu do të shfaqte shqetësimet dhe kundërshtimet e tij për zhvillimet politike të pasluftës. Ai filloi t'i diskutonte ato në predikimet e tij, si dhe refuzoi të merrte pjesë në ceremonitë që nuk ishin konform rregullave kishtarë.⁵ Në tetor të vitit 1946, ai u arrestua dhe në prill të 1947-s i komunikohet vendimi me 5 vjet heqje lirie. Pas dy vjetësh, Irineu u amnistua, u kurua dhe iu kërkua të bashkëpunonte për përgatitjen e materialeve të Kongresit të 3-të të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare. Irineu mori vendimin që të bashkëpunonte me qëllim që të ruante sa më shumë frymën kanonike të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare. Ai ishte një nga hartuesit e variantit të parë të projektstatutit të ri të kësaj kishe bashkë me teologët Theofan Popa dhe Dhimitër Beduli, dhe më pas korrektoi nga ana dogmatike variantin përfundimtar të tij.⁶ Gjatë kësaj periudhe, Irineu u mbajt i izoluar në Manastirin e Shën Vlashit në Durrës.

Qëndrimi i tij kundër rrëzimit të Kisit i shprehur hapur, si dhe refuzimi i tij pas punimeve të kongresit, për të dorëzuar peshkopë të rinj në kundërshtim me rregullat kanonike çuan në burgosjen e tij të dytë, në gusht të vitit 1952. Pas përfundimit të dënimit në burgun e Tiranës, ai u lirua në vitin 1957 dhe u internua në Manastirin e Ardenicës, ku ndërroi jetë në vitin 1973.

Raportet e vështira ekonomike të Kishës Ortodokse Shqiptare me shtetin komunist

Një nga aspektet më të vështira në marrëdhëniet e kishës me shtetin komunist, ishte ajo me natyrë ekonomike. Mbas çlirimit, shteti kreu reforma të thella në lëmin ekonomik, ndër të cilat Reforma Agrare ishte më e rëndësishmja. Ligji i Reformës Agrare i gushtit të vitit 1945 dhe zbatimi i tij, kishte në fokus marrjen e pronësisë tokësore pronarëve dhe dhënien e saj fshatarësisë. Duke qenë se kisha i administronte tokat me mënyrën e vetme që ekzistonte në Shqipëri në atë kohë, atë çifligare,

⁵ Dhimitër Beduli, *Episkop Irine Banushi - Martir i Kishës Orthodhokse Autoqefale Shqiptare*, botim i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë (Tiranë: 2000), 17.

⁶ *Po aty*.

popullsia fshatare jo vetëm nuk reagoi, por e përkrahu reformën në këtë aspekt.

Shqetësimin e kishës e gjejmë të pasqyruar në shkresat që zëvendësitë mitropolitane i dërgojnë Kryesisë në Tiranë. Në një prej tyre nga Mitropolia e Beratit, drejtuar Këshillit Ekonomik të Përherëshëm të kishës ndër të tjera thuhet: "...zbatuesi i reformës së ullaingje të Nartës, ka deklarue se kishave dhe manastireve të Myzeqesë, që kanë ullaing në rrethin e Nartës të Vlonës, u shpronësohen krejtësisht këto, pa shpërblim, në dobi të publikut. Meqenëse këto ullaing janë dhurue për nevojat e zakonshme të kultit ortodoks të Kishës dhe manastirit përkatës, si dhe përmbajtjen e zakonshme të tyre, kemi nderin t'ju lutemi me na lajmëruë masat, që do të ketë marrë i Hirshmi Këshilli Ekumenik ose organet e këtij".⁷

Gjatë vitit 1947 kemi të pasqyruar gjendjen e vështirë ekonomike që i krijoi kishës zbatimi i reformës. Kisha i paguante detyrimet shtetit si çdo subjekt joshtetëror dhe njëkohësisht subvencionohej prej tij. Tashmë, ajo do t'i drejtohet atij edhe për ndihma modeste ekonomike që ishin mjaft të rëndësishme për mbarëvajtjen e saj. Jeta e përditshme e klerit, në mënyrë të veçantë ceremonitë fetare si meshat, të kremtet, pagëzimet etj., i bënin të domosdoshme elemente si mielli për naforë, vaji i ullaingrit dhe dylli për qirinjtë. Reforma e detyroi kishën t'i drejtohej shtetit edhe për plotësimin e këtyre nevojave.

Letërkëmbimi i kryepeshkopit Kristofor me zëvendësmropolitin e Tiranës Harallamb Shundi dhe me selitë e peshkopatave të tjera pasqyron rrugën e vështirë të demarsheve të kishës pranë autoriteteve të larta shtetërore, për sigurimin e elementeve të domosdoshme për shërbesat fetare, si mielli dhe vaji.⁸ Ky raport mes kishës dhe organeve shtetërore do të ekzistojë në vazhdim. Viti 1947 ishte viti kur kisha e krasitur nga Reforma Agrare filloi të vuante edhe për nevojat më elementare si mielli apo vaji për meshim. Përpjekjet e klerikëve ortodoksë nëpër zyrat e shtetit për të plotësuar këto nevoja elementare, vazhduan gjatë gjithë këtij viti.

Kërkesave të vazhdueshme të Kryesisë së kishës, Ministria e Tregtisë iu përgjigj me shkresën e datës 23 shtator 1947, në të cilën e informonte

⁷ AQSH, F. 536, V. 1945, D. 756, fl. 2. Ekonomia, shkresë e Mitropolisë Berat drejtuar Kryesisë së KOASH-it (mungon data në dokumentin e mikrofilmuar).

⁸ Po aty, F. 536, V. 1947, D. 137, fl. 46. Ekonomia, shkresë e zëvendësisë episkopale Përmet drejtuar Kryesisë së KOASH-it, 23 dhjetor 1946.

kishën se ajo u kishte shpërndarë komiteteve ekzekutive nëpër rrethe qarkoren e saj të datës 26 prill 1947, për furnizimin e kishave me miell për shërbesat fetare dhe me kaq e quante çështjen të zgjidhur nga ana e saj.⁹

Demarshet mes kishës dhe shtetit për sorollatje të tilla vazhduan edhe në vitet në vazhdim. Ato u shoqëruan në mënyrë të ngadaltë, por progresive me shtetëzimin e pronave dhe të mirave materiale të kishës nga ana e shtetit. Një shembull të tillë e gjejmë në dokumentin në të cilin peshkopi i Korçës, Pasi i drejtonte Kryesisë së kishës më 25 maj 1948. Shkresa bënte fjalë për shtetëzimin e bagëtive të Manastirit të Voskopojës. Manastiri gjatë Luftës së Dytë Botërore kishte qenë baza e komunistëve dhe kishte strehuar spitalin partizan. Për këtë arsye, ishte djegur dhe dëmtuar shumë nga gjermanët. Pas luftës, ky manastir ishte prekur nga Reforma Agrare, e cila i kishte marrë tokat dhe pyllin, dhe së fundi i ishin shtetëzuar 300 kokë bagëti të imta plus 30 kuaj dhe mushka. Për këto arsye, Pasi i kërkoi Kryesisë që të bëjë demarshe dhe "...të kërkojë në mënyrë lutjeje..."¹⁰ pranë Ministrisë së Drejtësisë që këto bagëti të paguhen.

Po në vitin 1948, ka dy raste të dokumentuara kur kisha ankohet pranë autoriteteve shtetërore për kthimin e kishave në depo. Në një rast, zëvendësmropolit i Lushnjës i drejtohej më 11 shkurt 1948, me një letër Kryesisë të ndërhynte pranë autoriteteve për kthimin e kishës së Shën e Premtes në Lushnjë, në funksionin e saj të mëparshëm, sepse ishte shndërruar në depo duhani nga autoritetet vendore. Në rastin e dytë kemi një letër të zëvendëskryetarit dhe zëvendëskryepeshkopit Pasi, drejtuar Komitetit Ekzekutiv të Gjirokastrës më 7 gusht 1948, ku i kërkonte lirimimin e një kisha në qytet, e cila ishte kthyer në depo bari nga ushtria. Në vitin 1949, një nga çështjet që do të preokuponte kishën ishte çështja e selisë së Kryesisë së saj në Tiranë.

Në një sërë relacionesh mes Kryesisë dhe Komitetit për çështjet klerikale paraqitet problemi i godinës së Kryesisë. Në letrën e datës 5 mars 1949 të zëvendëskryepeshkopit Pasi, drejtuar Komitetit Ekzekutiv të KP - Tiranë, parashtrohej gjendja e Kryesisë së KOASH-it, e cila në nëntor të vitit 1948 pasi ia kishte dorëzuar godinën e saj zyrës së

⁹ *Po aty*, F. 503, V. 1947, D. 13, fl. 24. Qarkore e Ministrisë së Ekonomisë, 26 prill 1947.

¹⁰ *Po aty*, F. 536, V. 1947, D. 138, fl. 7. Ekonomi-Financë, shkresë e zëvendëskryepeshkopit të KOASH-it, 25 maj 1948.

strehimit, kaloi në godinën e bankës së vjetër ku banonte njëkohësisht dhe ish-pronari i saj. Ky i fundit, jo vetëm që nuk e lironte edhe pasi zyra e strehimit i kishte gjetur shtëpi, por e kishte kthyer pjesën e tij në oficinë, ndërkohë që marrëveshja e Kryesisë me zyrën e strehimit parashikonte lirin e godinës. Në një letër të datës 16 nëntor 1949, mësojmë se çështja e selisë së Kryesisë ende nuk ishte zgjidhur mbas afro 10 muajve. Dokumenti në fjalë është një shkresë e Komitetit Ekzekutiv - Tiranë, drejtuar Drejtorisë së Karburanteve në të cilën kërkohet shkëmbimi reciprok i zyrave me Kryesinë e kishës ortodokse, sepse kisha organizon kongresin e saj dhe nuk ka ambiente për pritjen dhe akomodimin e të huajve.

Në lidhje me këtë problem kemi dhe një letër të datës 17 nëntor 1949, të Paisit - tashmë kryepeshkop dhe kryetar i kishës - drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, në të cilën ai i kërkon të përshpejtohet çështja e këmbimit të godinave me Drejtorinë e Karburanteve pasi: "...godina ku strehohen sot zyrat e kësaj kryesie është e vjetër dhe e papërshtatshme për të pritur në vizitë delegacione të jashtme".¹¹

Probleme të tilla ekzistonin edhe në provincë. Në letrën që zëvendëspeshkopi i Gjirokastrës, Aristotel Strato, i dërgoi Paisit më 23 gusht 1949, i shprehte shqetësimin se organet e pushtetit popullor në Delvinë akoma nuk i kishin dorëzuar zyrat e okupuara të peshkopatës. "Demarshet e bëra pranë Komitetit Ekzekutiv në Sarandë, - shkruante Aristoteli, - nuk kishin bërë asnjë efekt dhe si pasojë 'zëv. episkopi mban libra dhe shkruan nëpër kafenetë e Delvinës'".¹² Në shkresat që Pasi i dërgoi Komitetit Ekzekutiv të Sarandës për këtë çështje në fund të vitit 1949, mësojmë se problemi ende nuk ishte zgjidhur.

Reforma arsimore

Reforma arsimore solli shtetëzimin e të gjitha shkollave private në vend e për konsekuencë të të vetmit seminar fetar ortodoks. Njëkohësisht me urdhëresë të veçantë u ndalua mësimdhënia e fesë nëpër shkolla, duke shndërruar karakterin laik të saj në një karakter me ngjyrim të fortë antifetar. Të ndodhur para kësaj situatë kleri manovroi, duke e kthyer

¹¹ *Po aty*, F. 536, V. 1948, D. 200, fl. 1. Ekonomi-Financë, letra dhe raporte.

¹² *Po aty*, F. 536, V. 1949, D. 273, fl. 1. Relacion i zëvendëspeshkopit Aristotel Strato, 23 gusht 1949.

mësimdhënien e fesë nëpër lokale private dhe në ambientet e kultit, por edhe kjo iu ndalua. Mbështetja që kisha dha për iniciativat ekonomike të shtetit, duke u angazhuar plotësisht me të gjitha kapacitetet e saj, nuk e ndryshoi qëndrimin intransigjent të qeverisë për të mos lejuar në asnjë mënyrë lejimin e mësimdhënies së fesë. Modeli i ri i shoqërisë, të cilin regjimi komunist synonte të ndërtonte dhe premisa leniniste që qëndronte në themel të këtij projekti, e klasifikonte fenë si një kundërshtarë të papajtueshme me të. Por, ky shndërrim do të ishte një proces gradual, i cili do të ecte paralel me emancipimin dhe zhvillimin e shoqërisë. Në këtë kuadër, edukimi i brezave të rinj ishte i një rëndësie shumë të madhe dhe regjimi nuk mund ta toleronte mësimdhënien e fesë, e cila përfaqësonte një botëkuptim të mykur dhe reaksionar për të.

Në kohën e regjimit të Ahmet Zogut, mësimi i fesë kryhej në mënyrë të alternuar në shkollat shtetërore.¹³ Gjatë Luftës së Dytë Botërore, pjesë e projekteve për shoqërinë e re ishte edhe Kongresi i 1-rë antifashist i arsimtarëve shqiptarë, i mbajtur në Korçë më 27 nëntor 1944. Një nga vendimet kryesore të tij ishte zhvillimi i arsimit laik në Shqipëri.¹⁴ Puna për ndërtimin e shoqërisë së re kërkonte, para së gjithash, brumosjen e rinisë me një edukim dhe arsimim të zhveshur nga ideologjia fetare. Komunistët shqiptarë e përdorën si premisë tezën leniniste të transformimit të shoqërisë së vjetër paralelisht me edukimin e brezave të rinj. Ky edukim, në hapat e parë laikë dhe më pas krejtësisht ateistë në përputhje të plotë me ideologjinë marksiste-leniniste, do të ishte një nga shtyllat e shtetit të ri shqiptar.

Një nga dokumentet e para që flet për qëndrimin e shtetit për çështjen e mësimi të fesë, është mësimi i saj nga klerikët jo nëpër faltore, por vetëm në shkolla, të ishte fakultativ, me tekste të aprovuara nga Ministria e Arsimit, dhe jo më shumë se 1 orë në javë. Në qarkoren e ministrit të Arsimit, prof. Kostaq Cipos me datë 14 shkurt 1945, drejtuar komiteteve ekzekutive të prefekturave, udhëzohej që mësimi i fesë të kryhej, programet të propozoheshin nga kleri por të miratoheshin nga Ministria e Arsimit, pagesa e klerikëve do të kryhej me të njëjtat kritere sikurse dhe mësuesit e tjerë. Ministri nuk harron t'i porosisë organet lokale të pushtetit: “Me këtë rast ju kujtojmë se qëndrimi juaj dhe i

¹³ *Po aty*.

¹⁴ *Po aty*, fl. 2.

arsimtarëve laikë, karshi dhënies së mësimit të fesë duhet të jetë korrekt nga çdo pikëpamje.”¹⁵

Edhe në këtë rast, procesi i mësimdhënies së fesë shtyhet dhe përsëri vijnë letrat e Kryesisë për zhbllokimin e situatës. Kisha e kishte praktikë konstante fillimin e mësimit të fesë në shkollat fillore, të cilat ishin rehabilituar dhe kishin filluar mësimin në fillim të vitit 1945. Në letrën drejtuar një muaj më vonë, më 14 mars 1945 Ministrisë së Drejtësisë, Kisi kërkon ndërhyrjen e kësaj për rifillimin e mësimit të fesë 1 orë në javë në shkollat fillore, pasi situata mbahej peng nga Ministria e Arsimit: “...e kemi për detyrë me paraqitë dëshirën e shumë fëmijëve dhe prindërve që kërkojnë të bëhet mësimi i fesë në shkollat fillore të paktën një herë në javë...”¹⁶ Një muaj më pas arriti në Kryesi një përgjigje pozitive nga seksioni i arsimit të nënprefekturës Tiranë, ku jepet autorizimi për mësuesit e fesë dhe i kërkohet asaj, të dërgojë në seksionin e arsimit, CV-të e tyre, si dhe një kopje të programit mësimor.

Më 17 maj 1945, ministri Cipo u dërgoi një qarkore tjetër komiteteve ekzekutive të prefekturave mbi tekstet që do të përdreshin në shkolla: “Për mësimin e fesë orthodokse, nër klasat e dyta, të treta, të katërta dhe të pesta, librat ‘Mësime fetare orthodhokse’ prej episkop Irineut, të botuara në shtypshkronjën ‘Luarasi’ 1943”.¹⁷ Gjatë periudhës 1945-1946, programi jofetar i shkollave në mënyrë graduale mori karakter antifetar. Shtetëzimi i të gjitha shkollave private në Shqipëri më 19 prill 1945, solli mbylljen e seminarit ortodoks “Apostull Pavli” dhe e vështirësoi mundësinë e dhënies së mësimeve fetare. Mbyllja e shkollave private, do t’i jepte shtetit të drejtën ekskluzive të detyrës së rëndësishme të edukimit. Raportet e kishës me shtetin në këtë aspekt do të dallonin nga ato të natyrës ekonomike për nga shkalla e vendosmërisë së regjimit të ri për ta përqendruar në dorën e vet të gjithë dhe sa më shpejt, sektorin e përgatitjes dhe të arsimit të shoqërisë në të gjitha hapësirat e saj.

Reforma arsimore e vitit 1946, theksonte karakterin ateist të mësimdhënies nëpër shkolla. Kjo do të çojë në distancimin e mëtejshëm të kishës nga shteti. Leximi i disa qarkoreve të Ministrisë së Arsimit, na

¹⁵ *Po aty*, F. 511, V. 1945, D. 24, fl. 1. Qarkore e Ministrisë së Arsimit, Tiranë, 14 shkurt 1945.

¹⁶ *Po aty*, F. 536, V. 1945, D. 49, fl. 2. Letër e KOASH-it drejtuar Ministrisë së Arsimit, Tiranë, 14 mars 1945.

¹⁷ *Po aty*, F. 511, V. 1945, D. 24, fl. 1. Qarkore e Ministrisë së Arsimit drejtuar komiteteve ekzekutive të prefekturave, Tiranë, 17 maj 1945.

krijon një ide se si u zhvillua kjo reformë. Në qarkoren e datës 17 janar 1946, ministri Cipo udhëzonte komitetet ekzekutive të prefekturave, për kryerjen e mësimit të fesë nëpër shkolla duke theksuar se mësimi i saj do të kryhej vetëm pas mbarimit të mësimeve të paradrekes dhe të pasdrekes, duke qenë fakultativ, dhe përsëriste se mësuesit do të paguheshin nga drejtoritë arsimore të komiteteve ekzekutive, sipas kritereve të përcaktuara për mësuesit e tjerë. Ndërkohë, një qarkore rezervate e Drejtorisë Shkolllore të Ministrisë së Arsimit, drejtuar komiteteve ekzekutive (seksioneve të arsimit) më 19 nëntor 1946, orientonte të përdroreshin të gjitha format dhe mënyrat për pengimin e mësimdhënies së fesë, e cila binte ndesh: "... me edukimin e brezit të ri me parimet e L.A.N.Ç.-it dhe në harmoni me shkencën..."

Duke qenë se reforma arsimore çonte në orarin unik të mësimeve - vazhdon qarkorja - dhe me klasa më të plota me nxënës që dëshirojnë të mësojnë fenë atëherë:

Gjithë seksioni dhe mësuesit e juridiksionit tuaj duhet t'a kenë të qartë se dhënia e mësimit të fesë në çdo formë që të bëhet është në kundërshtim me reformën arsimore dhe prandaj të përpiqi, që, si nxënësve ashtu dhe prindërve t'jau mbushni mendjen me arsyetime dhe gjykime të drejta se mësimi i fesë jo vetëm që nuk do t'u shërbente fëmijëve, por përkundrazi, do të pengonte edukimin e drejtë dhe shkencor të tyre.¹⁸

Në një artikull të mëvonshëm me titull "Lufta e P.P.SH. për realizimin e revolucionit ideologjik e kulturor", studiuesi Hamit Beqja do ta përshkruajë Reformën e 1946-s si "reforma që demokratizoi thellësisht arsimin popullor, siguroi arsimin falas, sanksionoi parimet themelore demokratike dhe socialiste të organizimit të arsimit popullor, ndërmjet të tjerash karakterin e plotë laik të saj".¹⁹ Po këtë vit, Ministria e Arsimit do të deklaronte se: "Reforma ka për qëllim t'i pastrojë fëmijët nga të gjitha paragjykimet, besëtytnitë dhe fanatizmi fetar."²⁰

¹⁸ *Po aty*, fl. 4. Qarkore e Ministrisë së Arsimit drejtuar komiteteve ekzekutive të prefekturave, Tiranë, 17 janar 1946.

¹⁹ Hamit Beqja, "Lufta e P.P.SH. për realizimin e revolucionit ideologjik e kulturor", në *Studime historike*, nr. 4, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë (Tiranë: 1966), 6.

²⁰ Edvin Jacques, *Historia e shqiptarëve nga antikiteti deri në ditët e sotme*, (Tiranë: Kartë e Pendë, 1998), 492.

Për t'u shpëtuar këtyre masave shtrënguese kleri ortodoks zgjodhi rrugën e mësimit të fesë në ambiente private, në lokale të vogla përreth kishave. Problemi i mësimit të fesë shqetësoi mjaft peshkopin Irine, i cili hodhi idenë e mësimeve nëpër kisha, duke u kërkuar besimtarëve t'i sillnin fëmijët në orare të caktuara për mësime katekizmi. Kjo do të ishte një arsye më shumë për arrestimin e prelatit të lartë në tetor të vitit 1946. Praktika e dhënies së mësimeve elementare të fesë në lokale të vogla afër kishave, do të ndalohet me një qarkore rezervate të Drejtorisë së Shkollave të Ministrisë së Arsimit më 7 shkurt 1947.

Në qarkoren drejtuar komiteteve ekzekutive me titull "Mbi ndalimin kryekëput të mësimit të fesë" orientoheshin të gjitha seksionet arsimore nëpër rrethe për masat që duhej të merreshin:

Seksionet Arsimore dhe gjithë trupi mësimor duhet ta kuptojnë mirë se mësimit fetare qofshin këto të predikuara nga klerikë ose laikë, janë mjaft të dëmshme për rininë tonë e cila në bazë të reformës së re shkollore duhet të rritet dhe t'edukohet simbas rrugës së drejtë që i cakton shkenca dhe jo të helmatiset me dogmat e kota e të dëmshme të fetarëve e të shërbëtorëve të tyre reaksionarë. Prandaj e përsërisim edhe njëherë tjetër që të ndaloni me çdo mënyrë qoftë edhe rastin më të vogël të dhënies së mësimit të fesë në rininë tonë. Seksioni i Arsimit dhe inspektorët e arsimit duhet të jenë vigjilentë dhe të kontrollojnë sektorët e tyre me kujdes duke bërë që mësimi i fesë te fëmijët të mos shihet kurrkund. Për ata që do të neglizhojnë në këtë drejtim do të merren masa disiplinore.²¹

Megjithatë gjatë vitit 1947, sipas Ministrisë së Drejtësisë, gjejmë aty-këtu, ndonjë rast të vazhdimit të mësimeve në kufizuar të fesë nëpër lokalet kishtare. Interesant është rasti i hetimit dhe i ndalimit të mësuesit të fesë Anastas Duka, i cili i udhëzuar nga Kryesia e kishës dhe i autorizuar nga Kisi shkoi të jepte mësime në rrethin e Fierit, në shkurt të 1948-s. Menjëherë ky mësues ndalohet. Me anë të një shkrese të sajën, duke iu referuar qarkores rezervate të 7 shkurtit 1947, Ministria e Arsimit i drejtohet Komitetit Ekzekutiv të Fierit, dhe i kërkon që ta ndalonte mësuesin Duka të jepte çdo formë të mësimit të fesë dhe t'i sekuestroheshin shënimet. Tashmë mësimi i organizuar i fesë për fëmijët

²¹ AQSH, F. 511, V. 1947, D. 16, fl.1. Qarkore e Ministrisë së Arsimit drejtuar komiteteve ekzekutive të prefekturave, Tiranë, 7 shkurt 1947.

është kujtim i së kaluarës. Në Kongresin e 1-rë të PKSH-së, në raportin e tij “Mbi arsimin dhe kulturën”, Enver Hoxha paraqet rezultatet e arritura me reformën arsimore në vitet 1946-1947:

Eshtë bërë unifikimi i programeve...shkenca e lartë, uniteti i teorisë me praktikën që edukojnë të mësuarit në nivelin e lartë ideologjik, janë ato parime me rëndësi dhe shenja dalluese të shkollës së re, të cilën ne po e krijojmë. Duke hequr të panevojshmet: mësimin e fesë, gjuhën latine, greqishten e vjetër, të ashtuquajturën shkencë mbi jetën..Në këtë vit shkollor në të gjitha shkollat e mesme hyri të mësuarit e marksizëm-leninizmit dhe të gjuhës ruse. Në të gjitha mësimet, duke marrë parasysh specifikat e tyre, bëhet te nxënësit formimi i botëkuptimit dialektik materialist.²²

Lëvizja për paqen. Kisi dhe raportet me kishën ruse

Viti 1948 përfaqëson një tjetër moment të rëndësishëm në zhvillimet e brendshme të shtetit dhe shoqërisë, forcimin e marrëdhënieve me Bashkimin Sovjetik. Pasi u shkëput nga “dara” jugosllave, udhëheqja shqiptare filloi procesin e instalimit të marrëdhënieve të ngushta shumëplanëshe me BS-në dhe udhëheqjen e tij. Gjithë zhvillimi ekonomik dhe shoqëror do të orientohej në vazhdim sipas modelit sovjetik.

Ky proces do të çonte në mënyrë të padiskutueshme në forcimin e raporteve midis kishave ortodokse të të dyja vendeve. Kisha ruse do të tregojë interes në këtë kuadër për të përfshirë kishën “motër” shqiptare në *Lëvizjen për Paqen*. Kjo e fundit ishte një alternativë e *Lëvizjes Ekumenike* të iniciuar nga kisha anglikane dhe që synonte bashkimin e të gjitha kishave. Jemi në momentet e fillimit të Luftës së Ftohtë që e ndau botën në dy kampe. Kisha ruse ishte prej kohësh nën kontrollin e regjimit stalinist dhe ishte lejuar të merrte frymë gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Ajo e kryesonte këtë lëvizje, e cila përmbante në vetvete disa qëllime:

- Të vendoste marrëdhënie të ngushta midis kishave ortodokse motra të Kampit Socialist.

²² Enver Hoxha, *Vepra*, vëll. 5 (tetor 1948 – nëntor 1948), Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste pranë KQ të PPSH-së (Tiranë: Naim Frashëri, 1970), 425; Nos Xhuvani, *Visarion Xhuvani apostull i atdhetarizmit dhe i ortodoksisë shqiptare* (Tiranë: 2003), 215.

- Të unifikonte qëndrimet e kishave në përshtatje me vijën politike të regjimeve të vendeve të tyre.
- E drejtuar nga kisha ruse ajo do të afirmonte edhe në këtë sferë të marrëdhënieve ndërshtetërore brenda Kampit Lindor rolin udhëheqës të Bashkimit Sovjetik.

Në këtë mënyrë Lëvizja për Paqen do të kthehej në shtrat bashkëpunimi të vazhdueshëm midis kishave të Kampit Lindor, gjithmonë nën udhëheqjen e asaj ruse. Kisha shqiptare nuk mund t'i shpëtonte gravitetit të këtij projekti, një proces i pashmangshëm për kohën. Kryepeshkopi Kisi nuk u tregua entuziast dhe refuzoi ftesën e patrikut rus Aleksej për të vizituar Moskën. Në këto momente gradohen dhe bëhen anëtarë të Senatit të shenjtë të kishës, dy peshkopë të rinj: Paskal Pashko dhe Dhimitër Kokoneshi, të dy njerëz të besuar të regjimit. Ngritja e tyre do të forcojë ndikimin e shtetit brenda Komunitetit Ortodoks.

K. Kisi u përpoq të mbante qëndrime të kujdesshme, të bënte të mundur mirëfunksionimin e kishës, pranoi të dorëzonte peshkop Paisin, i cili me gjithë kredencialet patriotike nuk përmbushte rregullat kanonike, pasi nuk vinte nga linja monastike. Marrëdhëniet mes klerit rus dhe atij shqiptar do të marrin hov gjatë viteve 1948-1949. Gjatë këtij procesi vërejmë mungesën e bashkëpunimit të kryepeshkopit shqiptar, Kristofor Kisi. Ky qëndrim shfaqet në refuzimin e tij për arsye “shëndetësore” të ftesave të patrikut rus Alekseit për të marrë pjesë në takimet dhe konferencat e organizuara në Moskë. Tërheqje të tilla ishin metoda e Kisit për të anashkaluar dhe për të shmangur probleme dhe pozicionime të papranueshme për të.²²

Kisi nuk është personalitet i panjohur edhe në Perëndim. Për këtë dëshmon futja e emrit të tij në periodikun “International Who is Who” - Londër 1947, e cila publikonte biografite e njerëzve të shquar të kohës. Etikën që i takonte një dinjitari të lartë fetar dhe drejtuesit të bashkësisë ortodokse, Kisi e ruajti në të gjitha momentet dhe ngjarjet që përfshinë kishën në këtë periudhë. Me rastin e vizitës së delegacionit të lartë të Kishës Ortodokse Ruse në Shqipëri, në prill të vitit 1948, ai impenjohet që kleri ortodoks shqiptar të bëjë një pritje sa më dinjitoze që të ishte e mundur. Kisi dëshironte që Kisha Ortodokse Shqiptare të linte përshtypje sa më të mira te përfaqësuesit e një kisha të madhe dhe me reputacion në botën ortodokse. Interesante është letra të cilën ai ia dërgoi më 17 mars

1948 Ministrisë së Drejtësisë, që kjo e fundit të ndërhynte pranë Ministrisë së Arsimit, e cila do të lejonte drejtorin e Liceut Artistik të formonte korin kishtar. Njëkohësisht Kisi i kërkoi Ministrisë së Drejtësisë të ndërhynte “...pranë dikastereve të ndryshme, ku punojnë shumë ish-pjesëtarë të korit të Kishës Katedrale të kryeqytetit në mënyrë që këta të liheshin të lirë mbas mbarimit të orarit zyrtar, për të marrë pjesë në korin e kishës”.²³

Delegacioni rus mbërriti më 14 prill 1948 dhe u prit me ceremoni në aeroport nga një delegacion klerikësh shqiptarë prej 30 vetash. Të nesërmen zhvillohet një ceremoni në Kishën Katedrale të kryeqytetit, ndërsa më 18 prill zhvillohet ceremonia fetare e hirotonisjes së arkimandritit Paskal Pashko në gradën e peshkopit nga kryepeshkopi shqiptar Kisi dhe peshkopi rus i Munkacevit. Do të jetë peshkopi i ri Paisi ai që do të kryesojë përsëri delegacionin e klerikëve ortodoksë shqiptarë në vizitën e dytë në BS. Në qershor të po këtij viti, Paisi do të emërohet zëvendëskryepeshkop dhe zëvendëskryetar i KOASH-it dhe në gusht të 1949-s do të bëhet kryepeshkop i kishës ortodokse.

Paskal Pashko lindi në fshatin Vodice të Kolonjës në vitin 1882, po në vendlindje dorëzohet prift në vjeshtë të vitit 1910. Nga ai moment do të thirret atë Paskal Vodica, arkimandrit Vodica dhe mbas hirotonisjes peshkop, Hirësia e Tij, Paisi Vodica. Për shkak të mendimeve dhe qëndrimeve të tij në dhjetor të vitit 1940, ai do të internohej për një vit në Itali. Arkimandrit Pashko Vodica do të bëhet përkrahës i Lëvizjes Nacionalçlirimtare dhe më 1942, si anëtar i këshillit krahinor nacionalçlirimtar të Kolonjës do të kalonte në ilegalitet. Në Konferencën e Labinotit në korrik të vitit 1943, zgjidhet anëtar i Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar, merr pjesë në Kongresin e Përmetit si delegat i Kolonjës dhe zgjidhet nga ai anëtar i KANÇ-it. Për kontributin e tij në luftë dekorohet me Urdhrin e Flamurit dhe Medaljen e Kujtimit.²³ I zgjedhur peshkop i Korçës dhe zëvendëskryepeshkop, Paisi do të bëhej protagonist në jetën e brendshme të Komunitetit Ortodoks. Protagonizmi i tij, në kontekstin e zhvillimeve politike dhe orientimit të ri të kishës shqiptare, do të kulmonte me mbledhjen e jashtëzakonshme të Sinodit të

²³ AQSH, F. 536, V. 1948, D. 216, fl.1. Qarkore e Ministrisë së Arsimit drejtuar komiteteve ekzekutive të prefekturave.

Shenjtë që do të shkarkonte Kisin duke zgjedhur Paisin si kryetar dhe kryepeshkop të ri të saj.²⁴

Mbledhja e jashtëzakonshme e Sinodit të Shenjtë u mbajt në gusht të vitit 1949. Në të merrnin pjesë: kryetari Kristofor Kisi - mitropolit i Tiranës dhe i Durrësit, zëvendëskryetari Paisi - peshkop i dioqezës së Korçës, arkimandrit Kokoneshi - zëvendëspeshkop i dioqezës së Beratit, ikonom Aristotel Strato-zëvendëspeshkop i dioqezës së Gjirokastrës dhe Niko Cano - sekretari i Përgjithshëm i Kryesisë së kishës (peshkopët Irine dhe Visarion janë në burg, ndërsa peshkopi Agathangel Camce ka vdekur në vitin 1946).

Në seancën e 2-të, më 24 gusht 1949, nga diskutimet e pasqyruara në procesverbal, mësojmë se prej kohësh në gjirin e udhëheqjes së KOASH-it ekzistonin mosmarrëveshje, sidomos mes Kisit dhe Paisit. Çështja e dorëzimit të Paisit hidhet në diskutim në fillim të mbledhjes nga Kisi ashtu si edhe pjesëmarrja në Sinod e anëtarëve jopeshkopë si Kokoneshi dhe Strato, në kundërshtim me statutin. Paisi polemizon në fjalën e tij, për pretendimet e Kisit në lidhje me arkimandrit Kokoneshin dhe ikonom Straton. Paisi i konsideron këta të dy të zgjedhur në mënyrë të rregullt me vendim sinodial, ndërkohë që Kisi i konsideron të caktuar nga kryetari (i kishës) në marrëveshje me autoritetet e larta shtetërore.

Leximi i mëtejshëm i procesverbalit të mbledhjes na jep të dhëna për zhvillimet e brendshme që po përjetonte kleri ortodoks në raportet e tij me pushtetin dhe në kontekstin politik të kohës. Në diskutimin e tij, sekretari i Kryesisë, Niko Cano, e akuzon Kisin se "...tjetër qëllim ka patur kryetari duke e riçelur përsëri këtë çështje të legalizuar plotësisht prej kohe dhe duke dashur që këto zgjedhje t'i paraqesë jo si zgjedhje të bëra legalisht dhe spontane prej tij dhe Sinodit por të kryera nën shtytjen e një faktori të jashtëm..."²⁵ Në debatet që pasojnë, kryepeshkopi insiston që këto zgjedhje ishin kryer jashtë rregullores së statutit dhe, në rastin e dorëzimit të Paisit, nën trysinë e pushtetit politik.

Më pas mbledhja vazhdoi me debatin mes Kokoneshit dhe Kisit, me akuza dhe kundëraakuza reciproke. Kokoneshi e akuzoi Kristoforin për shpërdorime, abuzime, përvetësim të pasurive kishtare, neglizhencë në punë, shkelje të statutit në dorëzimet e klerikëve, frymë klanore në

²⁴ *Biografi e hirësisë së tij Kryepiskopit të K.O.A.SH.-it Paisi Vodica*, (Tiranë: Zëri i Popullit, 1949).

²⁵ *AQSH*, F. 536, V. 1949, D. 224, fl. 5. Procesverbal i mbledhjes së Sinodit të Shenjtë.

emërimet e tyre, shpërdorime të pasurive të manastireve, shfaqje të tendencave antishqiptare dhe antiortodokse, qëndrime kundër autoqefalisë së kishës ortodokse, bashkëpunim me fashistët italianë, thirrje drejtuar popullit grek nga Radio Tirana për të dorëzuar armët para italianëve, prishje të imazhit të kishës ortodokse, tendenca dhe përpjekje për ta bashkuar kishën ortodokse me kishën romane, qëndrim jodashamirës ndaj kishës ruse, pritje të ftohtë të delegacionit rus, me sjellje jo të denja në publik etj. Mbas këtij lumi akuzash, në përfundim të seancës së dytë, arkimandrit Kokoneshi propozoi shkarkimin e Kristoforit.²⁶

Në seancën e 5-të të mbledhjes së jashtëzakonshme të Sinodit më 31 gusht 1949, Paisi shfaqet si kryepeshkop dhe kryetar i ri i KOASH-it. Në seancën e 6-të të mbajtur më 1 shtator 1949, në pikën 3 të vendimeve u vendos unanimisht prej Sinodit që, me iniciativën dhe me interesimin direkt të titullarëve të dioqezave, të mblidheshin të paktën një herë në muaj seminarët e priftërinjve të çdo rrethi, për t'iu mbajtur atyre konferenca në përputhje me vijën e re dhe për t'u dhënë udhëzime konkrete dhe të hollësishme se si duhet të punojnë për të mirën e kishës së popullit dhe pushtetit të tij. Gjatë diskutimeve u theksua se duhej t'iu qartësoheshin dhe t'iu viheshin mirë në dukje priftërinjve detyrat që i prisnin pranë famullive: "...për t'i folë e për t'i rekomanduar e për t'i shpjeguar popullit mbi realizimin e planeve të shtetit dhe të çdo ligji dhe urdhërese të cilat synojnë në ngritjen dhe lumturinë e gjithanshme të vendit tonë..."²⁷

Shkarkimi i Kisit nga pozicioni i tij ishte i pashmangshëm për të gjitha arsyet e trajtuara më sipër. Shteti ndikoi në zhvillimet e brendshme të kishës. Paisi dhe Kokoneshi ishin njerëz të afërt me regjimin e ri, ata ishin aktivistë të Luftës Antifashiste sidomos Paisi, Paskal Pashkoja, i cili ishte babai i Josif Pashkos, njërit prej drejtuesve të lartë të shtetit të ri komunist. Figura dhe personaliteti i Kisit njihet ende pak, për shkak të mungesës së burimeve dokumentare. Po kështu, këto burime që ekzistojnë sot nuk janë të mjaftueshme të faktojnë akuzat për simpatinë dhe bashkëpunimin me pushtuesit italianë në kundërshtim me frymën kanonike të ortodoksisë, për të cilat ai u akuzua dhe u shkarkua nga detyra e tij. Shkarkimi i Kisit ishte në kundërshtim me rregullat kanonike

²⁶ *Po aty.*

²⁷ *Po aty*, fl. 6. Procesverbal i mbledhjes së Sinodit të Shenjtë.

të kishës ortodokse, sepse vetëm një Sinod i përbërë prej peshkopësh kanonikë mund ta shkarkojë kryepeshkopin për faje të mirëpërcaktuara në statut.

Ligji i ri për komunitetet fetare

Në rrugën e kontrollit dhe të mobilizimit të institucioneve fetare akti më i rëndësishëm i qeverisë shqiptare ishte shpallja e dekretligjit nr. 743, datë 26 nëntor 1949. Dekreti doli në kohën kur Kisha Ortodokse Shqiptare përjetonte ndryshime të thella. Kleri ortodoks ishte privuar nga një pjesë e madhe e pronave të tij, nga shkollat fetare dhe mësimdhënia e fesë. Nga të katër peshkopët e Sinodit të Shenjtë mbas lufte, Camce kishte vdekur jo shumë kohë më parë, Kisi ishte larguar dhe izoluar, Irineu e Visarioni ishin arrestuar dhe burgosur.

Ligji me 36 nenet e tij përcaktonte një raport të ri në marrëdhëniet e klerit me shtetin në favor të këtij të fundit. Tre nenet e para garantonin të drejtat e besimit dhe të ndërgjegjes, ndarjen e kishës nga shteti dhe ndalimin e përdorimit të saj për qëllime politike. Këto nene ishin në konformitet me Kushtetutën e vitit 1946. Sipas nenit 7, komunitetet fetare që të njiheshin nga shteti dhe të funksiononin si persona juridikë duhej që të paraqitnin për aprovim statutet e tyre në Presidiumin e Kuvendit Popullor, me propozimin e qeverisë. Statuti duhej të përmbante sistemin e organizimit, të drejtimit dhe të administrimit të komuniteteve fetare, ndërsa rregulloret e nxjerra prej tij duhej të miratoheshin nga qeveria. Neni në thelb, u impononte komuniteteve fetare riorganizimin dhe njëkohësisht përshtatjen e detyruar të tyre me interesat e shtetit. Kjo përshtatje, që kushtëzohej me miratimin e statuteve të tyre nga Këshilli i Ministrave për të kaluar më pas në miratimin formal nga drejtuesit e Kuvendit, prezantohet si synim në nenin 12, ku shprehimisht thuhej: “Komunitetet fetare me aktivitetin e tyre duhet të zhvillojnë në besimtarët ndjenjën e besnikërisë ndaj pushtetit të popullit dhe të Republikës Popullore të Shqipërisë si dhe të forcojnë bashkimin kombëtar”.²⁸ Ky nen tregonte qartë se udhëheqja shqiptare ishte e vendosur ta angazhonte klerin përkrah programit të saj politik.

Neni 13 përcakton se, jo vetëm titullarët e komuniteteve fetare, por dhe klerikët e gradave apo shkallëve më të ulëta duhej të merrnin

²⁸ *Gazeta Zyrtare*, Dekret-Ligji nr. 743 (Tiranë: 26.11.1949), 3.

aprovimin e Këshillit të Ministrave, duke rritur shkallën e varësisë nga shteti. Neni 15 e përforcon duke theksuar se çdo komunitet fetar duhej të pezullonte dhe të largonte menjëherë titullarin ose çdo klerik tjetër me propozimin e qeverisë, dhe në rast mosbindjeje shteti ndërhynte me rrugë administrative. Neni 17 garantonte hapjen dhe mbajtjen e instituteve shkollore nga komunitetet fetare, ndërkohë që praktika e ndjekur deri atëherë si dhe orientimet e dhëna qartë në Kongresin e 1- rë të PKS-së për arsimin dhe kulturën linin pak vend për të besuar. Regjimi nuk do ta respektojë këtë të drejtë të sanksionuar në nenin 17, shkollat dhe seminarët fetare nuk do të rihapen. Nenet 18 dhe 19 forcojnë kontrollin e shtetit mbi klerin. Në nenin 18, thuhej se: “Të gjitha organet e komuniteteve fetare detyrohen t’i dërgojnë menjëherë për dijeni Kryesisë të Këshillit të Ministrave letrat pastorale qarkoret me karakter të përgjithshëm dhe çdo botim publik të përgatitur prej tyre. Këshilli Ministerial mund të ndalojë shpalljen, shtypjen dhe shpërndarjen e letrave, qarkoreve dhe botimeve të sipërme në qoftë se janë në kundërshtim me ligjet e Shtetit, rendin publik dhe zakonet e mira”.²⁹

Dërgimi i detyruar për miratim i letrave dhe qarkoreve të brendshme apo botimeve publike dëshmon kufizimin dhe kontrollin në aspekte të jetës së brendshme të klerit. Këtë e përforcon neni 19, i cili detyronte organet lokale të regjistroheshin pranë këshillave popullorë lokalë. Neni 21 u linte pak hapësirë klerikëve në ceremonialet dhe shërbimet fetare, nga ky moment e tutje të përmendurit e organeve të larta drejtuese të shtetit mund të bëhej vetëm sipas një formule të aprovuar më parë nga qeveria. Neni 22 nuk linte jashtë vëmendjes së autoriteteve edhe simbolet e komuniteteve, mbishkrimet, dhe vulat e tyre. Neni 23 theksonte se asnjë shoqatë apo organizatë fetare nuk mund të ushtronte aktivitete me karakter edukativ dhe formues për fëmijët dhe rininë, kjo veprimtari ishte ekskluzivitet i shtetit. Me nenet 25, 26 dhe 27 komuniteteve fetare u ndalohej të kishin lidhje të pavarura me komunitete fetare, institute, organizata dhe persona zyrtarë jashtë vendit. Këto relacione do të ishin të kontrolluara dhe të lejuara nga autoritetet shtetërore.³⁰

Këto 3 nene në thelb e izolonin Komunitetin Ortodoks shqiptar, tashmë lidhjet dhe aktivitetet me kishat ortodokse do të ishin të censuruara nga regjimi i ri. Izolimi i kishës nga raportet dhe aktivitetet e

²⁹ Po aty, 5.

³⁰ Po aty, 6.

përbashkëta me kishat e tjera ortodokse përbënte njëkohësisht edhe një nga kufizimet themelore të pavarësisë të saj. Nenet 31 dhe 32 dënojnë provokimet me përmbajtje fetare, si dhe të gjithë personat që pengojnë me çfarëdo mënyre besimtarët të ndjekin ritet e tyre fetare. Këto nene ashtu si dhe nenet 1, 2 dhe 3, ishin në konformitet me Kushtetutën shqiptare të 14 marsit të vitit 1946. Ato dëshmojnë për një kontradiktë të brendshme midis përmbajtjeve të neneve të Dekretit, si dhe një kontradiktë tjetër mes sjelljeve në praktikë të udhëheqjes shqiptare nga njëra anë dhe aspektit ligjor, nga ana tjetër. Këto kontradikta shprehin një lëkundje të udhëheqjes komuniste në këtë fazë të ndërtimit të shtetit, e arsytuar me influencën historike të fesë në sferën kulturore dhe shpirtërore të shoqërisë shqiptare, e cila e shihte atë si pjesë të pashkëputur të jetës.³¹

Pjesa më interesante e Dekretit janë nenet 33 dhe 35. Në nenin 33 shprehimisht thuhej: “Kushdo që formon organizata politike me baza fetare si dhe ay që me anë të fjalës të shtypit ose me mënyra të tjera duke përdorur kishën dhe fenë bën propagandë kundra pushtetit popullor dhe masave të mara prej tij, dënohet në qoftë se vepra nuk formon ndonjë faj më të rëndë, me privim të lirisë jo më pak se një vit.”³² Ky nen ndalon kthimin e fesë në një instrument politik dhe propagande kundër pushtetit në një kohë kur, në nenin 12 të përmendur më sipër, vetë regjimi i angazhonte institucionet fetare përkrah projektit të tij politik.

Neni 34 dënon me 3 vjet privim lirie të gjithë titullarët dhe funksionarët fetarë, të cilët fillonin nga detyra pa marrë aprovimin e qeverisë ose vazhdonin në funksion të tyre kur ishin pezulluar nga ajo, konform neneve 13 dhe 15 të Dekretit. Në nenin 35 shprehimisht thuhej: “Komunitetet fetare detyrohen që brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi të kësaj Dekret ligje t’i paraqesin Këshillit Ministerial për aprovim statutet e tyre të rregulluara në konformitet me dispozitat e kësaj Dekret-ligje. Në qoftë se statutet e paraqitura përmbajnë dispozita në kundërshtim me ligjet e Shtetit, rendin publik dhe zakonet e mira, Presidiumi i Kuvendit Popullor mund të kërkojë heqjen e tyre. Në qoftë se komuniteti fetar nuk konformohet me këtë kërkim, Presidiumi i Kuvendit Popullor mund t’a refuzojë aprovimin e Statutit.”³³

³¹ Po aty.

³² Po aty, 7.

³³ Po aty.

Me këtë nen shteti imponoi ripunimin dhe përshtatjen e statutit në përputhje me frymën e dekretligjit, duke lënë një afat kohor dhe duke e kushtëzuar njohjen nga ana e tij. Neni 36 përcaktonte detyrimin e kryesive të komuniteteve fetare të informonin me shkrim Këshillin e Ministrave për funksionarët fetarë. Në rast se qeveria mbas shqyrtimit të listave do të kishte kundërshtime për funksionarë të caktuar, këta do të largoheshin menjëherë.

Duke u imponuar komuniteteve fetare aprovimin dhe korrektimin e statuteve të tyre, aprovimin e të gjitha zgjedhjeve dhe emërimeve të brendshme hierarkike, krijimin e dosjeve personale për të gjithë klerikët pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe ndalimin e marrëdhënieve me organizata analoge jashtë shtetit pa miratimin e saj, udhëheqja komuniste e izoloi dhe e mbrehu në përmendën e vet kishën ortodokse ashtu si institucionet e tjera fetare në vend. Për të kontrolluar dhe për të mbikëqyrur shkallën e zbatimit dhe efektet e masave politike të saj, u krijua pranë Këshillit të Ministrave një zyrë e posaçme: Komiteti për çështjet klerikale. Vetëm nëpërmjet tij do të realizoheshin marrëdhëniet e kishës me shtetin.

Ky ishte një veprim me motive të pastra politike. Ai kishte si qëllim vënien përfundimtare nën kontroll të institucioneve fetare për t'i angazhuar plotësisht përkrah programit të vet politik. Në zbatimin e këtij programi, udhëheqja komuniste nuk mund të toleronte faktin që kisha ushtronte pushtet shpirtëror mbi një pjesë të shoqërisë. Në çështjet e pushtetit, regjimi i ri nuk mund të pranonte asnjë lloj rivali. Rolin tradicional të klerit duhej ta realizonin faktorë të tjerë që duhej të ishin jo thjesht aleatë, por produkt dhe instrument i regjimit. Këtë rol mobilizimi të shoqërisë do ta luanin organizatat e masave. Kongresi i 3-të i Kishës Autoqefale Ortodokse, i mbajtur në fillim të vitit 1950, do ta zyrtarizojë statusin e ri të saj deri në suprimimin e plotë të komuniteteve fetare në vitin 1967.

ÇLIRIM DURO

Universiteti i Tiranës
Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë
clirimduro@gmail.com

ARBEN JAUPAJ

Researcher
arben_jaupaj@hotmail.com

S u m m a r y

THE POLITICAL PROCESSES THAT MARKED THE SOUMISSION OF THE
AUTOCEPHALOUS ORTHODOX CHURCH FROM THE COMMUNIST STATE
1945-1949

The end of World War II found Albanian society with a modest institutional legacy. The country formed in 1912 by Albanian nationalists and recognized "de jure" as a principality under the great powers' guarantee had experienced political upheaval and two world wars, which had devastated infrastructure and the economy.

The new socio-economic model the state started to build began consulting with the Soviet advisers. Two meetings with the communist leadership in October 1945 and February 1946, as well as the constitution of January 1946, reflected a dichotomy between determination to maintain power and uncertainty about the construction of the new state.

The Albanian Orthodox Church was recognized by the Patriarchate in 1937 as an autocephalous church under the direction of archbishop Kristofor Kisi, but faced the Italian military occupation and nationalist currents that organized resistance to fascism. Internal developments in the Albanian Orthodox community were influenced by political processes in that period, as defined by official historiography.

Arrests and convictions of orthodox clerics on charges of collaboration with fascism will lead to educational and agrarian reforms, reducing the orthodox community's capacity to prepare clerical staff and meet economic

needs. This will lead to increased dependency on the state and its aid, leading to a gradual transformation of the Orthodox community from an independent or semi-independent entity to a collaborative and fully state-dependent entity.

The oscillations of the church's head, Kristofor Kisi, have been interpreted as a source of hope for the orthodox community and the independence of the albanian church. He hoped that society would save the democratic rights sanctioned in the constitution.

The autocephalous Orthodox Church's relationship with the communist state has ended, with the church being transformed into a popular organization supporting the state and its modernizing reforms.